

KNAUFINSULATION

ZGJIDHJET
DHE PRODUKTET
2017 / Albania

al.knaufinsulation.com

challenge.
create.
care.

Përmbajtja	fletë
Knauf Insulation	4-5
QËNDRUESHMËRIA	6-7
RËNDËSIA E IZOLIMIT	8-9
PRODUKTET PËR IZOLIM	10-11
ECOSE® Technology	12-13
ECOSE® Technology	14-15
SHENJËZIMI DHE ETIKETIMI / CERTIFIKATAT	16-17
IZOLIMI I KULMIT TË PJERRËT	18-19
IZOLIMI I KULMIT TË PJERRËT	20-21
IZOLIMI I HAPËSIRËS SË TAVANIT	22-23
IZOLIMI I MURIT TË FASADËS	24-25
IZOLIMI I MURIT TË FASADËS	26-27
IZOLIMI I MURIT TË FASADËS	30-31
IZOLIMI I MURIT NDARËS	32-33
IZOLIMI I KONSTRUKSIONIT TË DYSHEMESHË	34-35
IZOLIMI I PLAFONIT TË GARAZHIT DHE MURIT TË GROPOSUR/COKLËS	36-37
IZOLIMI I KULMIT TË RRAFSHËT	38-39
IZOLIM TEKNIK	40-41
URBANSCAPE KULM I GJELBËR	42-43
TABELA E APLIKIMIT TË PRODUKTEVE KNAUF INSULATION	44-45
APLIKIMI I PRODUKTEVE KNAUF INSULATION	46-47

MIRATUAR NGA NËNA NATYRË



Pas aplikimit të suksesshëm në prodhimin e pambukut mineral çelqor prej vitit 2009, Knauf Insulation prej datës 1 janar 2016 e futi ECOSE® Technology edhe në prodhimin e pambukut mineral guror.






Knauf Insulation uzinat e prodhimit

- PAMBUKU MINERAL
- PAMBUKU DRUSOR
- LAMINIMI
- PARAFABRIKIMI

Knauf Insulation

Si pjesë e grupacionit në pronësi të familjes Knauf, Knauf Insulation është njëri prej prodhuesve udhëheqës botëror të zgjidhjeve izoluese. Si kompani me rritje më të shpejtë në fushën e izolimeve, Knauf Insulation në përbërjen e saj ka gati 40 fabrika në Evropë dhe Amerikë dhe punëson mbi 5,000 njerëz.

Knauf Insulation në mbarë botën e plotëson nevojën në rritje për efikasitetin energjetik, mbrojtjen akustike dhe mbrojtjen nga zjarri në objektet e reja dhe ato ekzistuese banesore, publike, komerciale dhe industriale.



Misioni

Misioni ynë është që t'i rishqyrtojmë mënyrat konvencionale e të menduarit, të krijojmë zgjidhje inovative të izolimit, të cilat do të formësojnë mënyrën tonë të jetesës dhe do të ndërtojnë të ardhmen, duke u kujdesur për njerëzit të cilët i krijojnë dhe shfrytëzojnë këto zgjidhje, si dhe për botën nga e cila varemë të gjithë.

Knauf Insulation

Knauf Insulation është i pranishëm në Albania që nga viti 2005, kur fabrika e pambukut mineral guror në Surdulicë, Republika e Serbisë (e njohur më parë me emrin 'Vunizol') është bërë pjesë e Grupit Knauf. Fabrika ekziston që nga viti 1974, dhe në gjysmën e dytë e vitit 2007 është hapur linja tërësisht e rikonstruktuar për pambukun mineral guror, ndërsa kapaciteti i fabrikës është rritur disa herë.

QËNDRUESHMËRIA

garanci për të ardhmen

Kuptimi i qëndrueshmërisë është që të sigurojë kushtet më të mira të jetesës, si për njeriun, ashtu edhe për natyrën përreth nesh, dhe jo vetëm në momentin aktual, por edhe larg në të ardhmen. Efikasiteti energjetik i rritur është pjesë e rëndësishme e qëndrueshmërisë, sepse kontribuon, ndër të tjera, edhe në zvogëlimin e varësisë sonë nga lëndët djegëse fosile, dhe kështu edhe në reduktimin e emetimeve të CO₂.

Si një kompani e cila rritet dhe zhvillohet shpejtë, nuk mund të mbetemi imun ndaj ndikimeve dhe sfidave të jashtme, siç janë ndryshimet klimatike dhe varësia energjetike. Si një kompani e cila ofron sisteme me efikasitet energjetik, jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë të cilën e kemi që të mendojmë dhe të sillemi në mënyrë të qëndrueshme. Për këtë arsye Knauf Insulation ka strategjinë e vet të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel global, e cila na përcakton udhëzime të qarta drejt rrugës sonë për t'u bërë lider botëror në sistemet me efikasitet energjetik për ndërtesa.



Knauf Insulation ka caqe të qarta të zhvillimit të qëndrueshëm që kanë të bëjnë me ekonominë, mjedisin jetësor dhe komunitetin lokal.

EFIKASITETI ENERGJETIK çelësi drejt zhvillimit të qëndrueshëm

Ne sot e përdorim energjinë për pothuajse çdo gjë që bëjmë: për të shkuar në punë dhe për të udhëtuar, për t'i drejtuar makinat në industri, për ta ngrohur apo ftohur shtëpinë dhe për t'i mbushur bateritë e aparateve dhe pajisjeve të shumta, numri i të cilave rritet vazhdimisht.



Pjesa më e madhe e botës është zotuar për reduktimin e emetimeve të CO₂ për 20% deri në vitin 2020. Reduktimi i konsumit të energjisë në ndërtesa është kyç për arritjen e këtij caku, **meqenëse në ndërtesat konsumohet më tepër se 40% të energjisë së përgjithshme**. Ekzistojnë mënyrat e shumta për arritjen e këtij caku, dhe ato nënkuptojnë veprimin e përbashkët e shumë organizatave dhe njerëzve - duke përfshirë qeveritë, industrinë, komunitetet lokale, familjet dhe individët. Hapi më i rëndësishëm, megjithatë, është që secili prej nesh ta reduktojë individualisht sasinë e energjisë të cilën e konsumon dhe atë përmes **efikasitetit të rritur energjetik**.

IZOLIMI

çelësi për efikasitetin energjetik

Pothuajse gjysma e humbjeve termike në objektet klasike ndodh nëpërmjet konstruksioneve ndërtimore të mbështjellësit të ndërtesës - domethënë, nëpërmjet fasadës, kulmit dhe dysHEMEVE në tokë.

RËNDËSIA E IZOLIMIT

Kapaciteti i materialit izolues për ta mbajtur nxehtësinë është pikërisht ajo që e mban objektin të ngrohtë në dimër dhe të freskët në verë. Shtresa izoluese ndihmon që temperatura e brendshme të jetë e qëndrueshme, në atë mënyrë që ngadalëson transferimin e energjisë termike. Sa më i madh është dallimi i temperaturave në mes të brendësisë së objektit dhe jashtë tij, nevojitet shtresa më e trashë e izolimit për ta ngadalësuar kalimin e nxehtësisë.

KURSIMI I ENERGJISË

izolimi i duhur në vendin e duhur

A E DINI SE?

Madje 80% të shtëpive familjare në Serbi nuk ka fare izolim, ndërsa kemi një përqindje edhe më të madhe të objekteve publike që janë jashtëzakonisht joefikase në aspektin energjetik.

FASADA

Me instalimin e trashësive të parashkruara të materialit izolues vetëm në mbështjellësin e jashtëm të ndërtesës, mund të reduktojmë konsumin e energjisë për ngrohje dhe ftohje deri në 40%.

KULMI

Shpenzimin më të vogël të energjisë prej madje 30-35% e shënojmë nëse e izolojmë edhe kulmin - të pjerrët apo të rrafshët.

DYSHEMEJA

Dyshemeja e ftohtë është shumë e pakëndshme për banim, dhe përveç kësaj tregon edhe për humbje të tepruara termike. Me izolimin e dyshemesë në tokë i zvogëlojmë humbjet termike, dhe kështu edhe konsumin e energjisë deri në 13%.

ALEATI JUAJ

në kursimin e energjisë dhe mbrojtjen nga zhurma dhe zjarri

Knauf Insulation distribuon pambukun mineral guror me ECOSE® Technology, pambukun mineral qelqor me ECOSE® Technology, si dhe një sërë materialesh shtesë (membranat dhe foliet e kulmit, upat, rrjetëzat dhe plintueset (llajset) për fasada). Për këtë arsye kemi mundësi që blerësve t'ju ofrojmë zgjidhje complete në aspektin e ndërtimit me efikasitet energjetik, si dhe ekspertizën kulminante në fushën e këshillimit dhe veglave për përlogaritje.

with **ECOSE®**
TECHNOLOGY



Pambuku mineral guror me ECOSE® Technology

Materiali izolues me prejardhje minerale, i cili fitohet me shkrirjen e gurit me prejardhje vullkanike - dolomitit, diabazit dhe bazaltit - në temperaturat e larta, i cili pastaj tiset në fibra dhe me shtimin e lidhësit inovativ me ECOSE® Technology shndërrohet në pllakat izoluese. Izolues termik i shkëlqyeshëm në periudhën dimërore dhe verore, ka pikën e lartë të shkrirjes (mbi 1000°C), gjë që e bën material të padjegshëm në funksion të mbrojtjes nga zjarri. Gjithashtu, është absorbues i shkëlqyeshëm i energjisë së zërit.

Izolim ideal për të gjitha pozitat, sidomos atje ku kërkohet rezistenca më e madhe ndaj presionit, si dhe performansat e larta izoluese në periudhën e verës (kullmet e rrafshëta, dyshemetë, fasadat, nënçatitë).



with **ECOSE[®]**
TECHNOLOGY

Pambuku mineral qelqor me ECOSE[®] Technology

Material izolues me prejardhje minerale me përmbajtje të lartë të lëndëve të para të ricikluara, i cili fitohet me shkrirjen e rërës dhe zgjyrës së qelqit. Masa e shkrirë tiset në fibra të cilat, me shtimin e lidhësit inovativ me ECOSE[®] Technology, shndërrohen në rolle apo në pllaka izoluese.

Karakterizohet me performansat e shkëlqyeshme termike dhe akustike, si dhe të mbrojtjes nga zjarri, me pikën e shkrirjes prej rreth 700°C.

Është material izolues ideal për pozicionet të cilat nuk kërkojnë që materialet të jenë vetëbartëse, as fortësinë e lartë ndaj presionit (kulmet e pjerrëta, plafonët e lëshuar, muret ndarëse).

Materialet shtesë, aksesorët dhe veglat

Me qëllim që të sigurojmë një zgjidhje të gatshme për shfrytëzuesin, kemi përfshirë në ofertë edhe një gamë të materialeve shtesë: fletët, membranat dhe shiritat për kulmet, tavanet, fasadat e ventiluara dhe veshjet e murit, upat, rrjetëzën dhe plintueset për fasadën kontaktuese. Të gjitha këto produkte së bashku me materialet izoluese tradicionale i bëjnë zgjidhjet tona të plota, dhe aplikimin më të thjeshtë.



with **ECOSE[®]**  TECHNOLOGY



NATYRA E THA FJALËN E VET, NGJYRA **BRAON** E PAMBUKUT GUROR ËSHTË E VËRTETË.

ECOSE[®] Technology – teknologjia inovative tani edhe në prodhimin e pambukut mineral guror.

Çka është ECOSE[®] Technology?

ECOSE[®] Technology jështë një teknologji e re e lidhësit pa formaldehyd të shtuar, e bazuar kryesisht në materiet që ripërtërihen shpejtë në vend të kemikaleve në bazë të naftës. Për prodhimin e pambukut mineral me ECOSE[®] Technology nevojitet më pak energji se sa për prodhimin me lidhësin tradicional.

ECOSE[®] Technology është zhvilluar për izolimin nga pambuku mineral qelqor dhe pambuku mineral guror, por ofron përparësi të njëjta potenciale edhe për produktet e tjera ku zëvendësimi i lidhësit do të paraqiste avantazh.

ECOSE® Technology


Si funksionon ECOSE® Technology në prodhimin e pambukut mineral?

Me anë të shndërrimit të bio-materialeve në polimer inert në kuadër të procesit të mbrojtur, ECOSE® Technology përdoret për krijimin e një lidhësi jashtëzakonisht të fortë i cili i lidh fibrat e pambukut mineral. Ky zbulim revolucionar shkencor i ka mundësuar Knauf Insulation-it që ta zëvendësojë lidhësin tradicional me formaldehyd në industrinë e materialeve izoluese.

Potencialisht, ECOSE® Technology mund të përdoret edhe në industritë e tjera ku zëvendësimi i lidhësit do të paraqiste avantazh. Pas aplikimit të suksesshëm në prodhimin e pambukut mineral qelqor prej vitit 2009, Knauf Insulation prej datës 1 janar 2016 e futi ECOSE® Technology edhe në prodhimin e pambukut mineral guror.

NATYRAL PËR DHJETËSHE!

with **ECOSE®**
TECHNOLOGY



Knauf Insulation produktet nga pambuku mineral me ECOSE® Technology nuk i ngjajnë izolimit tjetër - ato janë me ngjyrë dhe braon, e cila është fituar pa shtimin e ngjyrave artificiale, pigmenteve apo akrileve.

Njëkohësisht, ato edhe më tutje i kombinojnë në mënyrë të njëjtë karakteristikat izoluese termike dhe akustike, si dhe karakteristikat mekanike me klasën më të lartë të reagimit ndaj zjarrit - A1 (materiale të padjegshme).

ECOSE® Technology



Me gjeneratën e re të pambukut mineral, të gjithë pjesëmarrësve në procesin e ndërtimit u sigurojmë cilësi shtesë, ndërsa objektet në të cilat është i montuar i sjellim më afër natyrës.

NIVELI MË I LARTË I QËNDRUESHMËRISË

Për shkak të përmbajtjes së lartë të lëndëve të para të ricikluara, lidhësit i cili harxhon më pak energji në prodhimin e tij dhe pasi që nuk ka formaldehyd të shtuar, pambuku mineral me ECOSE® Technology **kontribuon në përmirësimin e qëndrueshmërisë së përgjithshme të ndërtesave në të cilat është instaluar.**



NDËRTIMI I GJELBËR

Knauf Insulation produktet nga pambuku mineral **kontribuojnë në rejtungun e përgjithshëm të objekteve** në sistemet e rejtungut të aplikuara më së shumti të ndërtimit të gjelbër (LEED dhe BREEAM). Pambuku ynë mineral me ECOSE® Technology e përmirëson më tej kategorizimin e objekteve. Me montimin e pambukut mineral Knauf Insulation fitohen pikat shtesë falë lidhësit të biodegradueshëm pa formaldehyd të shtuar (ECOSE® Technology).

ECOSE® Technology

CILËSIA E AJRIT TË BRENDSHËM

Pambuku ynë mineral me ECOSE® Technology është shpërblyer me certifikatën **Eurofins Scientific's first Indoor Air Comfort Gold Standard** e cila është pjesë e **Eurofins Indoor Air Comfort Gold standard** të testimit dhe programit certifikues.



INOVATIVITETI

Teknologjia e lidhësit tonë, ECOSE® Technology, është një ndryshim revolucionar në industrinë e materialeve izoluese.

I LEHTË PËR MANIPULIM DHE MONTIM

Lidhësi në bazë të materialeve bio i bën produktet tona shumë më të buta, dhe në këtë mënyrë edhe më të lehta për manipulim dhe montim.

ÇMIMI

Është mbajtur çmimi i njëjtë për produktet Knauf Insulation nga pambuku mineral të gjeneratës së re me ECOSE® Technology.

IMPIANTI PRODHUES

Prodhimi i pambukut mineral Knauf Insulation me ECOSE® Technology në të gjitha fabrikat tona në mbarë Evropën është certifikuar me standardet kyçe internacionale nga seria ISO:

- ISO 9001:2008 Sistemi i menaxhimit të cilësisë,
- ISO 14001:2007 Sistemi i menaxhimit për mbrojtjen e mjedisit jetësor,
- OHSAS 18001:2007 Sistemi i menaxhimit të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë,
- EN ISO 50001:2011 Sistemet për menaxhimin e energjisë.

EKSPOZIMI NË VENDIN E PUNËS

Pambuku ynë mineral me ECOSE® Technology është prodhuar pa shtimin e formaldehidit.



SHENJËZIMI DHE ETIKETIMI




Të gjitha produktet nga pambuku mineral (guror dhe qelqor) duhet të jenë të prodhuara në përputhje të plotë me standardin:

EN 13162




Produktet për izolimin termik të ndërtesave - Produktet industriale nga pambuku mineral (MW) - Specifikimi

Produktet që janë të harmonizuara me standardin SRPS EN 13162 duhet të jenë të shënuara qartë, në atë mënyrë që ose në vetë produktin, ose në etiketën, ose në paketimin, do të kenë të dhënat në vijim:

Etiketa për pambukun mineral:

NaturBoard FIT			
R_D (m ² K/W)	Thicknes/Debljina (mm)		
2,63	100		
	λ (W/(m.K))		
	0,038		
Dimensioni/Dimensionja (mm x mm)	Pi./Kam.	m ²	
1000x600	6	3,6	
Rating	Standard/Referencë teknike		
	A1		
Standardi	SRPS EN 13162, EN 13162		
Data/Date	07.08.2016		
Shënime/Notes			
		270869	
			

Etiketa për pambukun qelqor:

UNIFIT 035			
R_D (m ² K/W)	Thicknes/Debljina (mm)		
2,86	60		
	λ (W/(m.K))		
	0,035		
Dimensioni/Dimensionja (mm x mm)	Pi./Kam.	m ²	
1200x9000	1	10,8	
Rating	Standard/Referencë teknike		
	A1		
Standardi	SRPS EN 13162, EN 13162		
Data/Date	07.08.2016		
Shënime/Notes			
		000000	
			

numri i pllakave
ne paketim
m² ne paketim

emri i prodhimit
trashesia e pllakes
/rollne
trashesigjatesia
e pllakes/rollne
gjeresia e pllakes/rollne
rezistenca
e nxehtesise

koficienti i perqeshmires
se nxehtesise
qertifikata EC mbi
performancen konstante

klasa e djegshmerise

kodi EC per shenim

numri i rrollneve
ne paketim
m² ne paketim

Kodi për shenjëzim duhet të jepet nga prodhuesi. Në rast kur nuk ekziston kërkesa për aplikim specifik, kodi duhet të përfshijë:

- Shkurtesën e termit për pambukun mineral
- Numrin e standardit evropian
- Devijimet e lejuara të trashësisë
- Stabilitetin e masave në temperaturë të përcaktuar
- Stabilitetin e masave në kushtet e përcaktuara të temperaturës dhe lagështisë
- Tensionin ose fortësinë në presion
- Fortësinë në tërheqje pingul në veshjet
- Ngarkesën pikësore

MW
EN 13162
Ti
DS(T+)
DS(TH)
CS(10\Y);
TRi
PL(5)i

- Absorbimin afatshkurtër të ujit
- Absorbimin afatgjatë të ujit
- Bartjen e avullit të ujit
- Ngurtësinë dinamike
- Ngjeshmërinë
- Të pëlciturit nën presion
- Koeficientin praktik të absorbimit të zërit
- Koeficientin e ponderuar të absorbimit të zërit
- Rezistencën ndaj rrjedhjes së ajrit

WS
WL(P)
MU; ili Zi
SDi
CPi
CC(i1/i2,y) σ
APi
AWi
AFi

ku "i" duhet të përdoret për të shënuar klasën ose nivelin përkatës, "σ" duhet të përdoret për shënimin e tendosjes nën presion, "y" për shënimin e numrit të viteve.

Shembulli i kodit për shënimin e produkteve nga pambuku mineral:

MW - EN 13162 - T6 - DS(T+) - CS(10)70 - TR15 - PL(5)100 - MU1 - CP3 - AP0,35 - AW0,40

KARAKTERISTIKAT DHE CERTIFIKATAT

Karakteristikat e produkteve nga pambuku mineral

Pasqyre e karakteristikave më të shpeshta të produkteve nga pambuku mineral guror dhe qelqor dhe shpjegimi.



Klasifikimi në lidhje me reagimin ndaj zjarrit

Klasifikimi i produkteve ndërtimore në lidhje me reagimin ndaj zjarrit sipas EN 13501 -1 është më i njohur si „Euroclass“. Ekzistojnë 7 klasa: A1, A2, B, C, D, E, dhe F. Klasifikimet shtesë janë për: krijimin e tymit s1, s2, s3 dhe pikave/grimcave të cilat digjen d0, d1, d2. Produktet e klasifikuara në klasën A1 nuk kontribuojnë në zhvillimin e zjarrit në asnjë fazë, duke përfshirë edhe zjarrin plotësisht të zhvilluar.



Koeficienti i përçueshmërisë termike λ_D

Për çdo tip të izolimit nga pambuku guror dhe qelqor, prodhuesi jep vlerën e deklaruar të koeficientit të përçueshmërisë termike λ (W/mK) e cila shënon sasinë e nxehtësisë të cilën e lëshon shtresa e ndonjë materiali të trashësisë njësoje, dhe atë pingul në sipërfaqen e tij, nën diferencën njësoje të temperaturave në gjendje stacionare ndërmjet sipërfaqeve kufitare të materialit. Kjo është madhësia e cila nuk varet nga trashësia e materialit izolues.



Dimensionet e produktit

Gjatësia dhe gjerësia e produktit nuk mund të ndryshojë nga vlera nominale më shumë se: gjatësia $\pm 2\%$, gjerësia $\pm 1.5\%$. Këndi i drejtë ndërmjet gjatësisë dhe gjerësisë së pllakës: $\leq 5\text{mm/m}$.

Rrafshësia e sipërfaqes së pllakës: $\leq 6\text{mm}$

Devijimet e lejuara nga trashësia nominale e produktit janë dhënë në tabelën në vijim:

Klasa	Devijimi i lejuar	
T5	-1 % ose -1 mm ¹⁾	+3% ose +5mm ²⁾
T6	-5 % ose -1 mm ¹⁾	+15% ose +3mm ¹⁾
T7	0	+10% ose +2mm ¹⁾

1) Vlera e cila e jep devijimin më të madh të lejuar

2) Vlera e cila e jep devijimin më të vogël të lejuar



Absorbimi i ujit

Cilësia e rezistencës ndaj ujit karakterizohet me absorbimin sipërfaqësor të ujit, respektivisht me absorbimin afatshkurtër të ujit WS (produkti i ekspozuar ndaj ujit në kohëzgjatje prej 24h nuk guxon të absorbojë më shumë se 1,0kg/m²) dhe absorbimin afatgjatë të ujit WL(P) (produkti i ekspozuar ndaj ujit në kohëzgjatje prej 28 ditësh nuk guxon të absorbojë më shumë se 3,0kg/m²).



Rezistenca ndaj rrymimit të ajrit

Për produktet izoluese fibroze, rezistenca ndaj rrjedhjes së ajrit (AFi) për njësi të gjatësisë pingul në sipërfaqen e materialit izolues nuk duhet të jetë më e vogël se 5kPa·s/m².



Fortësia në tërheqje pingul në sipërfaqen - delaminimi

Vlera e fortësisë në tërheqje pingul në sipërfaqen e materialit izolues omf(kPa) duhet të jetë më e madhe se vlera e deklaruar e delaminimit TRi – forca pingule në sipërfaqen e produktit e cila është e nevojshme për të shkaktuar këputjen e strukturës së produktit, respektivisht shtesëzimin.



Fortësia nën presion

Vlera e fortësisë nën presion në ngjeshje prej 10% σ_{10} (kPa) duhet të jetë më e madhe se vlera e deklaruar CS (10)i – forca pingule në sipërfaqen e cila është e nevojshme për të shkaktuar zvogëlimin e trashësisë së produktit për 10%.



Kompresibiliteti – ngjeshmëria

Vlera e kompresibilitetit c (mm), e cila përcaktohet si diferenca e trashësive të produktit dL para ngarkesës dhe dB nën ngarkesë, duhet të jetë më e vogël se vlera e deklaruar CPi. Kjo shenjë e cilësisë përdoret për produktet për izolimin e dyshemeve.



Ngarkesa pikësore

Deklarohet ngarkesa pikësore, Fp, gjatë deformimit prej 5mm dhe sipas niveleve prej 50N. Kjo shenjë e cilësisë përdoret tek produktet për izolimin e kulmeve të rrafshëta.



Shenja CE

Shenja CE paraqet konfirmimin se produktet nga pambuku guror dhe qelqor prodhohen në përputhje të plotë me standardin EN 13162.



EUCB

EUCB paraqet konfirmimin e trupit të pavarur me të cilin garantohet se produktet i përmbushin kriteret për materialet jo-kancerogjene, respektivisht për materialet që nuk janë të dëmshme për shëndetin.



EUROFINS Indoor Air Comfort GOLD

Programi certifikues Eurofins Indoor Air Comfort kombinon kriteret e rregulloreve të obligueshme dhe vullnetare, të përcaktuara nga organizatat certifikuese kombëtare dhe trupat certifikuese private, siç janë Blue Angel, M1, AgBB, AFSET dhe të tjera. Shenja GOLD / E ARTË konfirmon se produkti i përmbush standardet më të larta të mundshme në grupin e caktuar të produkteve që kanë të bëjnë me cilësinë e ajrit të brendshëm; gjithashtu, siguron përputhshmërinë me çdo auditim nga palët e treta i cili mund të pasojë më vonë.



CoCoP - Certifikata e qëndrueshmërisë së performancave,

në pajtim me rregulloren për produktet ndërtimore të Parlamentit Evropian dhe Këshillit 305/2011/EU, konfirmon se të gjitha dispozitat në lidhje me vlerësimin dhe verifikimin e performancave të përshkruara në Shtojcën ZA të standardit EN 13162:2012+A1:2015 janë zbatuar sipas sistemit 1 dhe se **vetitë kyçe të reagimit ndaj zjarrit për produktet i përmbushin të gjitha kërkesat e përcaktuara si më sipër.**



DoP - Deklarata mbi vetitë, është pjesë kyçe e Rregullores për produktet ndërtimore. Çdo produkt ndërtimor i cili i takon standardit të harmonizuar evropian duhet të ketë Deklaratën mbi vetitë dhe të jetë i certifikuar me shenjën CE.

IZOLIMI I KULMIT TË PJERRËT – NËN BRINJËT

Përse duhet të izolohet kulmi?

Kulmi është pjesë e mbështjellësit të objektit përmes së cilit humbet më së shumti energji - madje deri në 35%! Më së shpeshti përbëhet nga konstruksioni i lehtë nga druri - është më së shumti i ekspozuar ndaj ndikimeve të jashtme, prandaj nënçatia mbinxehet shpejtë gjatë verës dhe ftohet gjatë dimrit.

PËRPARËSITË E PAMBUKUT MINERAL

STABILITETI TERMIK

Pambuku mineral është një izolues termik kulminant i cili ofron mbrojtjen ideale termike gjatë sezonit të ftohtë. Në periudhën e verës vjen deri te mbinxehja e hapësirës së banimit. Temperatura nën mbulesën e kulmit mund të arrijë madje deri në 80°C, dhe në këtë temperaturë materiali izolues joadekuat në kulm shkrihet! Pambuku mineral është plotësisht termikisht i qëndrueshëm (shkrihet në 1000°C), nxehet më vështirë, e mban nxehtësinë më gjatë dhe shumë më vonë e lëshon atë në hapësirën e brendshme për dallim nga materialet e tjera termoizoluese, duke e ruajtur kështu një temperaturë të këndshme në hapësirën jetësore.

NËNÇATIA "MERR FRYMË"

Pambuku mineral është material i përshkueshëm nga avulli i cili mundëson që avulli i ujit në mënyrë të papenguar, dhe pa rrezik nga kondensimi, të del nga hapësira e brendshme, dhe në këtë mënyrë krijon kushtet e këndshme të qëndrimit në nënçati.

SIGURIA

Pambuku mineral është material i padjeggshëm i cili, në rast të zjarrit, do të parandalojë përhapjen e zjarrit dhe krijimin e gazrave toksike nga të cilat në fakt bien viktima më shumë njerëz se sa nga vetë zjarri.

CILËSIA MË E MIRË E AJRIT

Pambuku mineral me lidhësin e biodegradueshëm ECOSE® Technology kontribuon në përmirësimin e cilësisë së ajrit në hapësirat ku jetojmë.

PUTHITJA IDEALE


Pambuku mineral e ka strukturën fleksibile. Lu përshtatet në mënyrë ideale distancave të parregullta të brinjëve, duke i mbyllur në mënyrë të përkryer të gjitha largesat e vogla përmes së cilave "rrjedh" energjia.

TRASHËSIA E REKOMANDUAR E IZOLIMIT: 20-25cm

IZOLIMI NËN BRINJËT – ZGJIDHET DHE PRODUKTET

KULMI I VENTILUAR - VESHJA E DISTANCUAR ME DËRRASA

1. Membrana e përkueshme nga avulli-e papërkueshme nga uji, **Homeseal LDS 0.02** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT**
2. Pambuk guror, **NaturBoard FIT PLUS** / NaturBoard FIT, 12cm
3. Pambuk qelqor, **Unifit 035** / Ekoroll, 8cm
4. Barriera aktive e avullit, **Homeseal LDS 5 SILK** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT** + shiriti me ngjitje të dyanshme, **Homeseal LDS SOLIFIT 2**



KULMI I VENTILUAR - PA VESHJE ME DËRRASA

1. Membrana e përkueshme nga avulli-e papërkueshme nga uji, **Homeseal LDS 0.02** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT**
2. Pambuk guror, **NaturBoard FIT PLUS** / NaturBoard FIT, 12cm
3. Pambuk qelqor, **Unifit 035** / Ekoroll, 8cm
4. Barriera aktive e avullit, **Homeseal LDS 5 SILK** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT** + shiriti me ngjitje të dyanshme, **Homeseal LDS SOLIFIT 2**



KULMI I PAVENTILUAR - PLLAKAT OSB NGA ANA E SIPËRME

1. Shtresa e papërkueshme nga avulli (letër bituminoze, barriera e avullit, tegola,...)
2. Pambuk guror, **NaturBoard FIT PLUS** / NaturBoard FIT, 12cm
3. Pambuk qelqor, **Unifit 035** / Ekoroll, 8cm
4. Barriera e avullit, **Homeseal LDS 35 (LDS 200)** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT** + shiriti me ngjitje të dyanshme, **Homeseal LDS SOLIFIT 2**



KULMI I PAVENTILUAR - PLLAKAT OSB NGA ANA E SIPËRME

1. Pllakat OSB
2. Pambuk guror, **NaturBoard FIT PLUS** / NaturBoard FIT, 12cm
3. Pambuk qelqor, **Unifit 035** / Ekoroll, 8cm
4. Barriera e avullit, **Homeseal LDS 35 (LDS 200)** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT** + shiriti me ngjitje të dyanshme, **Homeseal LDS SOLIFIT 2**



KULMI I PAVENTILUAR -> KULMI I VENTILUAR (ME ANË TË QEPRAVE)

1. Membrana e përkueshme nga avulli-e papërkueshme nga uji, **Homeseal LDS 0.02** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT**
2. Pambuk guror, **NaturBoard FIT PLUS** / NaturBoard FIT, 12cm
3. Pambuk qelqor, **Unifit 035** / Ekoroll, 8cm
4. Barriera aktive e avullit, **Homeseal LDS 5 SILK** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT** + shiriti me ngjitje të dyanshme, **Homeseal LDS SOLIFIT 2**



PAMBUKU GUROR DHE QELQOR

	NaturBoard FIT PLUS	NaturBoard FIT	Unifit 035	Ekoroll
Koeficienti i përkueshmërisë termike (λ)	0.037 (W/mK)	0.038 (W/mK)	0.035 (W/mK)	0.044 (W/mK)
Reagimi ndaj zjarrit	A1	A1	A1	A1
Përkueshmëria nga avulli	~1	~1	~1	~1
Dimensionet (mm)	1000x600	1000x600	1200mm gjerësia (gjatësia varet nga trashësia)	1200mm gjerësia (gjatësia varet nga trashësia)
Trashësia (mm)	40-200	50-200	50-160	50-200

MEMBRANAT DHE SHIRITAT

	Homeseal LDS 0.02	Homeseal LDS 5 SILK	Homeseal LDS 35	Homeseal LDS 200	Homeseal LDS SOLIFIT	Homeseal LDS SOLIFIT 2
Përkueshmëria nga avulli (Sd)	0,02 (m)	5 (m)	35 (m)	200 (m)	-	-
Pesha (g/m²)	90	110	100	90	-	-
Dimensionet	1.5x50m	1.5x50m	1.5x50m	1.5x50m	Gje.-60mm / Gja.-25m	Gje.-38mm / Gja.-50m
Trashësia (mm)	0.34	0.36	0.24	0.27	0.34	0.30

IZOLIMI I KULMIT TË PJERRËT – MBI BRINJËT

Duhet të izoloni nënçatinë

- por nuk dëshironi të ndryshoni asgjë në brendësi?

Keni një nënçati shumë të bukur, jeni lodhur rreth enterierit, jeni krenar me trarët të cilët i jepin hapësirës pamjen rustike...

Për më tepër, pjerrësitë në nënçati janë pikërisht ashtu siç dëshironi, hapësira është e kufizuar dhe çdo ndryshim do të rrezikonte komoditetin tuaj.

Nga ana tjetër, ju jeni i vetëdijshëm se është koha e fundit që të vendosni izolimin, ngase, çfarë vlere ka i tërë ky enterier i këndshëm, kur në dimër në asnjë mënyrë nuk mund të ngrohni mjaftueshëm hapësirën, ndërsa gjatë verës asnjëherë nuk mund ta freskoni mjaftueshëm, edhe pse kondicioneri punon ditë-natë?

PËR FAT, EKZISTON ZGJIDHJA - NËNÇATIA MUND TË IZOLOHET EDHE NGA ANA E JASHTME!

Në këtë mënyrë, gjithçka që tashmë keni bërë për nënçatinë tuaj do të mbetet e paprekur. Dhe për më tepër, do ta kurseni dukshëm hapësirën, sepse duhet të pranohet se trashësitë e mëdha të izolimit të cilat duhet të vendosen në konstruksionin e kulmit shpesh shkojnë në dëm të hapësirës.


TRASHËSIA E REKOMANDUAR E IZOLIMIT: 20-25cm

IZOLIMI MBI BRINJËT

– ZGJIDHJET DHE PRODUKTET


SANIMI – MBI BRINJËT

1. Membrana e përkueshme nga avulli-e papërkueshme nga uji, **Homeseal LDS 0.02** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT**
2. Pambuk guror, **SmartRoof Top**, 8cm
3. Pambuk qelqor, **Unifit 035** / Ekoroll, 12cm
4. Barriera aktive e avullit, **Homeseal LDS 5 SILK** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT** + shiriti me ngjitje të dyanshme, **Homeseal LDS SOLIFIT 2**




SANIMI – MBI PLLAKËN E BETONIT

1. Membrana e përkueshme nga avulli-e papërkueshme nga uji, **Homeseal LDS 0.02** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT**
2. Pambuk guror, **SmartRoof Top**, 8cm
3. Pambuk qelqor, **Unifit 035** / Ekoroll, 12cm
4. Barriera aktive e avullit, **Homeseal LDS 5 SILK** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT** + shiriti me ngjitje të dyanshme, **Homeseal LDS SOLIFIT 2**






NDËRTIMI I RI – MBI BRINJËT

1. Membrana e përkueshme nga avulli-e papërkueshme nga uji, **Homeseal LDS 0.02** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT**
2. Pambuk guror, **SmartRoof Top**, 4cm
3. Pambuk qelqor, **Unifit 035** / Ekoroll, 12+6cm
4. Barriera aktive e avullit, **Homeseal LDS 5 SILK** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT** + shiriti me ngjitje të dyanshme, **Homeseal LDS SOLIFIT 2**



PAMBUKU GUROR DHE QELQOR

	SmartRoof Top	Unifit 035	Ekoroll
Koeficienti i përçueshmërisë termike (λ)	0.038 (W/mK)	0.035 (W/mK)	0.044 (W/mK)
Reagimi ndaj zjarrit	A1	A1	A1
Përkueshmëria nga avulli	~1	~1	~1
Dimensionet (mm)	1200x2000 	1200mm gjerësia (gjatësia varet nga trashësia) 	1200mm gjerësia (gjatësia varet nga trashësia) 
Trashësia (mm)	40-200	50-160	50-200

MEMBRANAT DHE SHIRITAT

	Homeseal LDS 0.02	Homeseal LDS 5 SILK	Homeseal LDS SOLIFIT	Homeseal LDS SOLIFIT 2
Përkueshmëria nga avulli (Sd)	0,02 (m)	5 (m)	-	-
Pesha (g/m ²)	90	110	-	-
Dimensionet	1.5x50m	1.5x50m	Gje.-60mm / Gja.-25m	Gje.-38mm / Gja.-50m
Trashësia (mm)	0.34	0.36	0.34	0.30

IZOLIMI I PLLAKËS NË HAPËSIRËN E TAVANIT

A e ngrohni edhe ju hapësirën të cilën nuk e shfrytëzoni?

Nëse nuk keni mundësi për të izoluar konstruksionin e kulmit, bëni gjënë më të mirë të radhës - izoloni pllakën në hapësirën e tavanit dhe parandaloni shpërndarjen e energjisë nga hapësira e ngrohur së poshtmi.

Kjo formë e intervenimit është skajshmërisht e thjeshtë dhe e shpejtë. Nuk është i nevojshëm angazhimi i ekzekutuesve profesional sepse sanimi përbëhet nga stivimi i thjeshtë i materialit termoizolues mbi pllakën.

Me këtë intervenim të thjeshtë e ruani energjinë termike dhe kështu edhe paratë, të cilat humbasin përmes tavanit të paizoluar në hapësirën e ftohtë të tavanit - hapësirën e cila nuk shfrytëzohet.


TRASHËSIA E REKOMANDUAR E IZOLIMIT: 10cm

HAPËSIRA E TAVANIT – ZGJIDHJET DHE PRODUKTET

TAVANI MBI TË CILIN NUK SHKELET

1. Barriera aktive e avullit, **Homeseal LDS 5 SILK**
2. Pambuk guror, **NaturBoard FIT PLUS** / NaturBoard FIT, 10cm ose Pambuk qelqor, **Ekoroll**, 10cm
3. Membrana e përkueshme nga avulli-e papërkueshme nga uji, **Homeseal LDS 0.02*** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT**


* Vendoset mbi izolimin termik, nëse në nënçati depërtojnë uji i shiut, bora...



TAVANI MBI TË CILIN SHKELET

1. Barriera aktive e avullit, **Homeseal LDS 5 SILK**
2. Pambuk guror, **NaturBoard FIT PLUS** / NaturBoard FIT, 10cm ose Pambuk qelqor, **Ekoroll**, 10cm
3. Membrana e përkueshme nga avulli-e papërkueshme nga uji, **Homeseal LDS 0.02*** + shiriti ngjitës, **Homeseal LDS SOLIFIT**

* Vendoset mbi izolimin termik, nëse në nënçati depërtojnë uji i shiut, bora...



PAMBUKU GUROR

	NaturBoard FIT PLUS	NaturBoard FIT
Koeficienti i përkueshmërisë termike (λ)	0.037 (W/mK)	0.038 (W/mK)
Reagimi ndaj zjarrit	A1	A1
Përkueshmëria nga avulli	~1	~1
Dimensionet (mm)	1000x600	1000x600
Trashësia (mm)	40-200	50-200

PAMBUKU QELQOR

	Ekoroll
Koeficienti i përkueshmërisë termike (λ)	0.044 (W/mK)
Reagimi ndaj zjarrit	A1
Përkueshmëria nga avulli	~1
Dimensionet (mm)	1200mm gjerësia (gjatësia varet nga trashësia)
Trashësia (mm)	50-200

MEMBRANAT DHE SHIRITAT

	Homeseal LDS 5 SILK	Homeseal LDS 0.02	Homeseal LDS SOLIFIT
Përkueshmëria nga avulli (Sd)	5 (m)	0.02 (m)	-
Pesha (g/m ²)	110	90	-
Dimensionet	1.5x50m	1.5x50m	Gje.-60mm / Gja.-25m
Trashësia (mm)	0.36	0.34	0.34

IZOLIMI I MURIT TË FASADËS – FASADA KONTAKTUESE (ETICS)

Përse duhet të izoloohen muret e jashtme?

Humbjet termike përmes mureve të jashtme përbëjnë edhe deri në 40% të humbjeve të përgjithshme në objektin e paizoluar. Prandaj, izolimi i mureve të jashtme është gjithmonë masa e parë e përmirësimit të efikasitetit energjetik.

PËRPARËSITË E PAMBUKUT MINERAL në sistemin e fasadës kontaktuese

MBROJTJA TERMIKE

Gjeneratat e reja të pambukut mineral me koeficientin e përcueshmërisë termike qysh prej 0,034, ofrojnë një mbrojtje termike të shkëlqyeshme e cila është e përshtatshme për të gjitha llojet e sipërfaqes (tulla, bllok me vrima, beton, beton poroz...). Një përparësi shtesë është komforti termik gjatë verës kur pambuku mineral për shkak të strukturës dhe dendësisë së tij parandalon depërtimin e nxehtësisë në objekt.

PËRSHKUESHMËRIA NGA AVULLI – MURI „MERR FRYMË“

Pambuku mineral guror është material i përshkueshëm nga avulli i cili mundëson që avulli i ujit në mënyrë të papenguar, dhe pa rrezik nga kondensimi, të del nga hapësira e brendshme, dhe në këtë mënyrë krijon kushtet e këndshme të qëndrimit në hapësirë.

MBROJTJA NGA ZJARRI

Pambuku mineral është material i padjegshëm. Në qoftë se duhet të projektohet dhe të montohet sistemi i padjegshëm i fasadës kontaktuese, kjo mund të arrihet vetëm në atë mënyrë që materiali izolues të jetë pambuku mineral. Vetëm në këtë rast, sistemi i fasadës kontaktuese mund të merr klasifikimin A2 s1(s2)d0.

Në pajtim me Rregulloren e re për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe eksplozimet, për objektet e kategorisë V është përcaktuar përdorimi i materialeve termoizoluese të paktën B-s2,d2, ndërsa për objektet e kategorive G dhe D është përcaktuar

përdorimi i materialeve të padjegshme A2-s1,d0, gjegjësisht A1. Pambuku mineral guror i plotëson të gjitha kërkesat e përmendura. Për sistemet ETICS të cilat nuk janë realizuar në tërësi nga materialet e padjegshme, përcaktohet obligimi i vendosjes së barrierave nga materiali i padjegshëm, në çdo të dytin kat, në gjerësi prej 50cm, për të parandaluar përhapjen e zjarrit mbi fasadën.

IZOLIMI AKUSTIK

Problemin e mbrojtjes nga zhurma e jashtme e shqyrtojmë zakonisht atëherë kur ballafaqohemi me të! Atëherë zakonisht është vonë ose është shumë vështirë të zgjidhet njëri prej armiqve më të mëdhenj të kohës moderne.


Pambuku mineral, për shkak të strukturës së tij specifike fibroze, ofron izolimin e shkëlqyeshëm të hapësirës së brendshme nga zhurma e jashtme.

TRASHËSIA E REKOMANDUAR E IZOLIMIT: prej 8cm dhe më lartë


FASADA KONTAKTUESE – ZGJIDHJET DHE PRODUKTET

FASADA KONTAKTUESE - PLLAKAT NGA PAMBUKU MINERAL

1. Muri i jashtëm
2. Ngjitësi për pambukun mineral guror
3. Pambuku guror, **FKD-S Thermal** / FKD-N Thermal, FKD-N Thermal 2, 8cm
4. Upë me gozhdë çeliku, **KI H1 Eco** / **KI LFM** / **KI LMX**
5. Ngjitësi për pambukun mineral guror (shtresa I)
6. **Knauf Insulation rrjetëza e qelqit**
7. Ngjitësi për pambukun mineral guror (shtresa II)
8. Lyerje bazike për suvanë dekorative
9. Suva dekorative
10. Elementet shtesë për fasadën kontaktuese, **plintuese Knauf Insulation**



FASADA KONTAKTUESE – ASORTIMENTI SHITESË



UPAT

KI H1 ECO

Upë plastike me gozhdë çeliku
Gjatësitë e disponueshme të upave 95–295 mm

KI LMX/ LFM

Upë plastike me gozhdë çeliku Gjatësitë e disponueshme të upave 120–300 mm



RRJETËZA
E PLASTIFIKUAR
E QELQIT

KI RRJETËZA E QELQIT

Qëndrueshmëria alkale
e cilësisë së lartë, fortësia
e madhe në tërheqje
>2200N/cm






PLINTUESET

KI PLINTUESET

Plintuese këndore, profili
për shpaleta, profili kontaktues

PAMBUKU GUROR

	FKD-S Thermal	FKD-N Thermal	FKD-N Thermal 2
Koeficienti i përçueshmërisë termike (λ)	0.035 (W/mK)	0.034 (W/mK)	0.035 (W/mK)
Reagimi ndaj zjarrit	A1	A1	A1
Fortësia në presion CS(10)	≥ 30 kPa	≥ 20 kPa	≥ 40 kPa
Delaminimi TR(10)	≥ 10 kPa	$\geq 7,5$ kPa	≥ 10 kPa
Përshkueshmëria nga avulli	~ 1	~ 1	~ 1
Dimensionet (mm)	1000x600 	1000x600 	1000x600 
Trashësia (mm)	30–200	80–200	80–200

IZOLIMI I MURIT TË FASADËS

– FASADA E VENTILUAR

Kur fasada e ventiluar është zgjidhja ideale?

Fasada e ventiluar është zgjedhja e parë për objektet afariste, hotelet dhe ndërtesat e tjera ekskluzive, për shkak të karakteristikave kulminante termike, cilësisë së veshjes përfundimtare, momentit estetik dhe qëndrueshmërisë së tërë konstruksionit të fasadës.

